

UDHËZIM
Nr.20, datë 19.6.2009

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 9.03.2009 “PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 23 pika 1, germa “b”, nenit 40 e vijues të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

Neni 1

Në nenin 10 të udhëzimit nr.4, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin Komisionit të Qendrës së Votimit” shtohet pikat 3, 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

3. Me qëllim mbledhjen dhe dërgimin e informacionit në lidhje me orën e hapjes së procesit të votimit, pjesëmarrjen në votime në intervale kohore 3 orëshe, rastet e ndërprerjes dhe rifillimit të votimit, si dhe me mbylljen e votimit në ditën e votimit, datë 28 qershor 2009, sekretarët e QV-ve kanë për detyrë të dërgojnë informacion në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ky informacion do të realizohet nga sekretarët e QV-ve, nëpërmjet mesazheve tekst, të dërguara nga një numër celular të deklaruar pranë KZAZ-ve drejt numrave celularë 068 420 420 6 dhe 068 420 420 9. Informacionet e ardhura nga numra të tjerë celular nuk do të merren parasysh në proces dhe informacioni i asaj QV-je do të quhet i padërguar. Sekretarët e QV-ve janë të vetmit që kanë të drejtë të mbajnë telefon celular në ambientet e qendrës së votimit. Mosdërgimi i informacionit ngarkon me përgjegjësi sekretarin e QV-së përkatëse.

4. Sekretarët e QV-ve në intervale kohe të caktuara si më poshtë do të dërgojnë informacionin në lidhje me:

- a) 07:30 Informacion për orën e hapjes së qendrës së votimit;
- b) 10:30 Informacion për numrin e pjesëmarrjes në votim (nr. i zgjedhësve që kanë votuar);
- c) 13:30 Informacion për numrin e pjesëmarrjes në votim (nr. i zgjedhësve që kanë votuar);
- d) 16:30 Informacion për numrin total të pjesëmarrjes në votim (nr. i zgjedhësve që kanë votuar);
- e) 19:00 Informacion për numrin e pjesëmarrjes në votim (nr. i zgjedhësve që kanë votuar);

f) 19:00 Informacion për orën e mbylljes së qendrës së votimit (sipas rastit);

g) Përmbajtja e mesazhit do të jetë si më poshtë:

- | | |
|-----------|---|
| - HAPUR | DO TË DËRGOHET NË ORËN 7:30 |
| - XXX | NUMRI I ZGJEDHËSVE QË KANË VOTUAR 10:30 |
| - XXX | NUMRI I ZGJEDHËSVE QË KANË VOTUAR 13:30 |
| - XXX | NUMRI I ZGJEDHËSVE QË KANË VOTUAR 16:30 |
| - MBYLLUR | DO TË DËRGOHET NË ÇASTIN KUR MBYLLET |
| - XXX | NUMRI TOTAL I ZGJEDHËSVE QË KANË VOTUAR 19:00 |

5. Në çdo rast që ka parregullsi që çojnë në ndërprerjen e procesit të votimit, sekretari i QV është i detyruar të dërgojë njoftim, me mesazh, që në momentin e ndërprerjes ose rifillimit të procesit të votimit.

a) Përmbajtja e mesazhit do të jetë si më poshtë:

- 1. NDËRPRERË
- 2. RIFILLUAR

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Arben Ristani